

Dokument qëndrimi

VLERËSIM I REFORMAVE TË LIGJIT PËR MEDIA TË MAQEDONISË SË VERIUT - NJË HAP I PJESSHËM DREJT STANDARDEVE EVROPIANE

Lëshuar nga:
Fondacioni për internet dhe shoqëri Metamorfozis

Prill 2025

Dokument qëndrimi

Vlerësim i reformave të Ligjit për Media të Maqedonisë së Veriut - Një hap i pjeshëm drejt standardeve evropiane

Lëshuar nga: Fondacioni për internet dhe shoqëri - “Metamorfozis”,

Data: 23 prill 2025

Përmbledhje e shkurtër

Maqedonia e Veriut po i nënshtrohet reformave në legjislacionin e saj për mediat, duke synuar përafrimin me standardet e Bashkimit Evropian (BE). Fondacioni Metamorfozis e mirëpret iniciativën e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për të harmonizuar legjislacionin kombëtar të mediave me standardet evropiane, veçanërisht në kontekstin e Kapitullit 23 të legjislacionit të BE-së dhe Ligjit Evropian për Lirinë e Medias (LELM). Megjithëse ndryshimet e propozuara në Ligjin për Media mund të përfaqësojnë një hap në drejtimin e duhur duke e zgjeruar kornizën rregullatore për të përfshirë mediat online, ato ngrenë shqetësime se për shkak se trajtojnë vetëm pjesërisht çështjet sistemore në mjedisin mediatik dhe nuk përputhen mjaftueshëm me dispozitat e LELM-së. Prandaj, ne bëjmë thirrje për një proces reformash gjithëpërfshirëse, inkluzive që ka për qëllim miratimin e një Ligji të ri për Mediat që i pasqyron plotësisht normat evropiane dhe garanton mbrojtjen e lirisë së mediave, pavarësinë redaktuese dhe të drejtat e gazetarëve.

Për më tepër, megjithëse një ligj krejtësisht i ri për mediat ishte hartuar tashmë me ndihmën e ekspertëve të BE-së gjatë viteve të kaluara, për arsye të panjohura dhe pa dhënë shpjegime publike, Qeveria zgjodhi vetëm ta ndryshojë ligjin e vjetër ekzistues duke adresuar vetëm një pjesë të çështjeve kontestuese, në vend që të propozojë ligjin e ri gjithëpërfshirës.

Ky dokument i qëndrimit i vlerëson ndryshimet e propozuara, duke nënvizuar si përparimet ashtu edhe sfidat e vazhdueshme, dhe ofron rekomandime për të siguruar lirinë gjithëpërfshirëse të mediave dhe përafrimin me direktivat e BE-së.

Konteksti dhe analiza

Ndryshimet aktuale synojnë të inkorporojnë mediat online në diapazonin rregullator të Ligjit për Media dhe të prezantojnë një Regjistër të Mediave Online nën mbikëqyrjen e Agjencisë për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike (ASHAAM). Këto ndryshime janë përshtatur si pjesë e detyrimeve të Qeverisë sipas Udhërrëfyesit për Sundimin e Ligjit dhe synojnë të përmirësojnë transparencën në pronësinë, financimin dhe reklamimin e mediave.

Pavarësisht disa përmirësimeve të prezantuara përmes procesit të ndryshimit të ligjit, duke përfshirë përshtatjet e kriterëve për punësim për t’u përfshirë në regjistër, korniza e

propozuar ligjore mbetet e harmonizuar në mënyrë të pamjaftueshme me LELM-në. Në veçanti, ajo nuk arrin të trajtojë fusha kritike si pavarësia redaktuese, masat mbrojtëse kundër mbikëqyrjes dhe përqendrimin e pronësisë në sektorin e mediave digjitale. Gjithashtu, arsyetimi zyrtar për ndryshimet e paraqitura nga qeveria përfshinte qëllimin për të luftuar dezinformatat, ndërsa propozimi aktual nuk ofron mekanizma të tillë.

Gjetjet kryesore

1. Harmonizimi i pjesshëm me LELM-në

Edhe pse ndryshimet e propozuara në Ligjin për Media në Maqedoninë e Veriut prezantohen si hapa drejt përafrimit me standardet evropiane, harmonizimi me LELM-në mbetet i kufizuar dhe i pamjaftueshëm. Veçanërisht, përkufizimi i mediave online në propozim-ligj ndryshon nga terminologjia e LELM-së. LELM-ja e përdor vazhdimisht termin "ofruesit e shërbimeve mediatike", i cili siguron qartësi dhe konsistencë në të gjithë kornizat legislative, duke përfshirë edhe Direktivën e Shërbimeve Audio dhe Audiovizuale Mediatike. Propozimi i Maqedonisë e ruan referencën e vjetruar "botuesit e mediave", që mund të çojë në paqartësi interpretuese dhe të pengojë zbatimin efektiv të ligjit. Për më tepër, mungojnë dispozitat kritike të LELM-së, duke përfshirë:

- **Neni 22 (Pluralizmi i mediave):** Amendamentet aktuale nuk e trajtojnë çështjen e përqendrimin të pronësisë së mediave, veçanërisht në sektorin online, ku vazhdojnë boshllëqet rregullatore. Ky lëshim mund të përkeqësojë rrezikun e monopolizimit dhe të zvogëlojë diversitetin e pikëpamjeve në të cilat ka qasje publiku.
- **Neni 6.3 (Të drejtat e gazetarëve dhe pavarësia redaktuese):** Propozim-ligjit i mungojnë mekanizmat e qartë për të mbrojtur gazetarët nga ndërhyrjet arbitrare të pronarëve apo drejtuesve të mediave, e as nuk ofron garanci ligjore për sigurinë e vendit të punës dhe pavarësinë profesionale.
- **Neni 4 (Mbrojtja nga mbikëqyrja):** Nuk ka dispozita që i mbrojnë gazetarët dhe aktorët mediatikë nga mbikëqyrja e paligjshme digjitale ose softuerët për spiunim ("spyware") - një shqetësim në rritje në mjediset bashkëkohore të mediave digjitale.

Këto lëshime paraqesin një mundësi të humbur për të krijuar një kornizë ligjore të fortë dhe të bazuar në të drejta për lirinë e mediave në përputhje me normat e BE-së.

2. Mbrojtje e pamjaftueshme kundër padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike (MKPSKPS)

MKPSKPS-ja vazhdon të jetë një sfidë e madhe për lirinë e mediave në Maqedoninë e Veriut. Këto padi zakonisht iniciohen nga individë të fuqishëm, korporata ose aktorë politikë me qëllim që t'i ngarkojnë gazetarët, aktivistët ose mediat me beteja ligjore që janë të kushtueshme dhe zgjasin shumë, në mënyrë që t'i dekurajojnë të angazhohen në raportim hulumtues ose në gazetari me interes publik. Megjithëse Bashkimi Evropian ka prezantuar

rekomandime dhe propozim-ligje që synojnë të frenojnë abuzimin e gjyqësorit për të heshtur shprehjen e mendimit ndryshe, ndryshimet e propozuara në Ligjin për Media të Maqedonisë nuk përfshijnë masa të ngjashme mbrojtëse.

Konkretisht, reformat nuk parashikojnë:

- **Mekanizma për hedhjen poshtë të hershme të padive** që do t'u mundësonte gjyqtarëve të njihnin dhe të hidhnin poshtë MKPSKPS-të në një fazë të hershme;
- **Masa mbrojtëse procedurale** për të parandaluar paditësit të zgjedhin në mënyrë të qëllimshme gjykata që janë më të favorshme për ta ose për të përdorur taktika procedurale për t'i vonuar procedurat gjyqësore;
- **Sanksione për përdorimin abuziv të sistemit gjyqësor** ose mekanizma kompensimi për gazetarët dhe organizatat mediatike të synuara;
- **Ndihmë juridike ose korniza për mbështetje** për t'i ndihmuar të akuzuarit në aspekt të barrës financiare të padive të tilla.

Në mungesë të këtyre mbrojtjeve, aktorët mediatikë mbeten të pambrojtur ndaj ngacmimit ligjor, i cili mund të nxisë auto-censurën dhe të dobësojë gazetarinë hulumtuese – veçanërisht për çështjet që përfshijnë korrupsionin, krimin e organizuar ose përgjegjësinë e sektorit publik.

3. Mungesa e transparencës mbi pronësinë e mediave

Sigurimi i transparencës mbi pronësinë e mediave është thelbësor për ruajtjen e pavarësisë redaktuese, mbrojtjen nga konfliktet e interesit dhe promovimin e pluralizmit mediatik. Megjithatë, ndryshimet e propozuara legislative nuk kanë arritur të prezantojnë mekanizma të fortë për të adresuar paqartësinë e vazhdueshme në strukturat e pronësisë, veçanërisht në peizazhin e mediave online.

Boshllëqet aktuale përfshijnë:

- **Nuk ka regjistër publik gjithëpërfshirës** që e paraqet në mënyrë të detajuar zinxhirin e plotë të pronësisë së medias, duke përfshirë pronarët përfitues, burimet e financimit dhe lidhjet e ndërsjella të pronësisë;
- **Detyrimet e pamjaftueshme për zbulimin e pronësisë** për mediat online, të cilat shpesh i nënshtrohen një shqyrtimi më pak të rreptë se sa transmetuesit tradicionalë;
- **Nuk ka kornizë zbatuese** për të hetuar ose ndëshkuar mosrespektimin e rregullave të transparencës së pronësisë.

Kjo mungesë transparence mundëson lidhje të fshehura midis pronarëve të mediave dhe elitave politike ose ekonomike, të cilat mund të rrezikojnë integritetin redaktuese dhe të mashtrojnë publikun në lidhje me pavarësinë dhe besueshmërinë e informacionit që e konsumojnë. Situata është veçanërisht shqetësuese në një mjedis mediatik shumë të

polarizuar, ku ndikimi i pronësisë shpesh lidhet me raportimin partiak dhe mbulimin e njëanshëm të ngjarjeve.

4. **Ndikimi i vazhdueshëm politik dhe censura e butë**

Pavarësisht garancive formale kushtetuese dhe ekzistencës formale të një kornize rregullatore të pavarur, ndikimi politik mbi peizazhin mediatik në Maqedoninë e Veriut mbetet i rrënjësor thellësisht. Ky ndikim ushtrohet jo vetëm nëpërmjet pronësisë së drejtpërdrejtë ose kontrollit redaktues partiak, por edhe nëpërmjet formave më delikate të "censurës së butë".

Manifestimet kryesore të këtij problemi përfshijnë:

- **Alokimin diskriminues të reklamave shtetërore** dhe të fondeve për komunikim të qeverisë, të cilat shpesh u jepen mediave të orientuara politikisht ose përdoren për të shpërblyer mbulimin e favorshëm dhe për të ndëshkuar zërat kundërshtues;
- **Presionet joformale mbi vendimet redaktuese**, duke përfshirë përmes rrjeteve personale ose politike, frikësimit ose kërcënimit për tërheqjen e fondeve;
- **Mosveprimin rregullator ose zbatimin selektiv të ligjit**, ku autoritetet dështojnë të trajtojnë shkeljet nga mediat e afërta me partitë politike duke aplikuar një kontroll më të rreptë ndaj mediave të pavarura.

Praktikat e tilla e shtrembërojnë tregun mediatik dhe i minojnë parimet thelbësore të lirisë së shtypit dhe llogaridhënies demokratike. Ato gjithashtu kontribuojnë për një vetë-censurë të shkaktuar nga frika e pasojave ligjore apo politike, ku gazetarët mund të shmangin tema të diskutueshme ose të ndjeshme politikisht për të mbrojtur të ardhurat e tyre për jetesë ose sigurinë personale. Ndryshimet e propozuara nuk vendosin masa të reja mbrojtëse kundër këtyre praktikave, as nuk përfshijnë mekanizma për transparencë dhe llogaridhënie më të madhe në marrëdhëniet financiare midis shtetit dhe mediave.

5. **Angazhime të paqarta për reformat e ardhshme**

Udhërrëfyesi i Qeverisë për Sundimin e Ligjit, i cili shërben si bazë për përpjekjet aktuale legislative, e përshkruan një ambicie për të zgjidhur çështjet e pazgjidhura rregullatore deri në vitin 2028. Megjithatë, ky angazhim është më tepër aspirativ sesa detyrues. Nuk ka një afat kohor specifik, sekuencë të hapave të reformës, apo mekanizëm të qartë të llogaridhënies publike. Për më tepër, dokumentet kryesore, siç është Propozim-ligji i parashikuar për Shërbimet Digjitale (që synohet të përputhet me Ligjin për Shërbime Digjitale të BE-së - LSHD), ose nuk janë të disponueshme për publikun ose nuk janë dorëzuar ende në Parlament. Sipas Kapitullit 31 të Legjislacionit të BE-së për vendet candidate (Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes) Maqedonia e Veriut është gjithashtu e detyruar të zhvillojë mekanizma për të ndërtuar qëndrueshmëri ndaj dezinformative, gjë që nuk është reflektuar në ndryshimet e Ligjit për Mediat.

Kjo mungesë transparence dhe sigurie ligjore minon besimin e publikut dhe mund të vonojë realizimin e reformave gjithëpërfshirëse të nevojshme për integrimin në BE.

6. Kërcënimet ndaj mediave lokale dhe atyre të specializuara:

Versioni fillestar i ndryshimeve të propozuara kërkonte që mediat online të kishin të paktën tre punonjës me orar të plotë në mënyrë që të kualifikoheshin për t'u përfshirë në regjistrin zyrtar të mediave. Kjo dispozitë përbënte një kërcënim ekzistencial për shumë organizata mediatike të vogla, lokale dhe jofitimprurëse, të cilat shpesh funksionojnë me burime të kufizuara njerëzore dhe financiare. Pas angazhimit konstruktiv nga shoqatat e mediave dhe shoqëria civile, kjo kërkesë u rishikua për të lejuar që këto media të kenë dy punonjës me orar të plotë, me përjashtime shtesë për mediat lokale dhe ato të specializuara për të përfshirë kontribuues me orar të pjesshëm ose me honorar. Ndonëse ky është një hap pozitiv, nevojiten sqarime të mëtejshme dhe fleksibilitet për të siguruar që mediat që u shërbejnë popullatave të cenueshme, pakicave ose atyre gjeografikisht të izoluara, të mos përjashtohen pa dashje ose të rëndohen nga kërkesat disproporcionale rregullatore.

7. Nevoja për koherencë ligjore

Qasja në mënyrë të pjesshme dhe jo të koordinuar në zbatimin e reformës aktuale nuk arrin të sigurojë koherencë në të gjitha fushat përkatëse të legjislacionit. Ekziston një nevojë urgjente për të integruar procesin e reformës së Ligjit për Mediat me përpjekjet e tjera legjislative që janë në rrjedhë e sipër si dhe ato të ardhshme, veçanërisht ato që lidhen me rregullimin digjital, siç është përshtatja e Ligjit për Shërbime Digjitale (LSHD). Pa këtë harmonizim ndërsektorial, mund të lindin mospërputhje dhe mbivendosje, duke minuar potencialisht zbatimin e të drejtave të mediave dhe atyre digjitale. Një kornizë legjislative gjithëpërfshirëse që e përafron LELM-në, LSDH-në dhe instrumentet e tjera përkatëse është thelbësore për krijimin e një ekosistemi mediatik rezistent dhe të sigurt për të ardhmen, në Maqedoninë e Veriut.

Rekomandimet e politikave

Harmonizimi i pjesshëm me Ligjin Evropian për Lirinë e Mediave (LELM)

1. Të miratohet terminologjia dhe përkufizimet që janë në përputhje me LELM-në:

Të rishikohet përkufizimin ligjor i aktorëve mediatikë në Ligjin për Mediat për ta përafruar me terminologjinë e LELM-së, veçanërisht duke miratuar termin "ofrues të shërbimeve mediatike" në vend të "botues të mediave". Ky përafrim siguron përputhje me tekstet ligjore të BE-së si Direktiva e Shërbimeve Audio dhe Audiovizuale Mediatike (DSHAAM) dhe e lehtëson bashkëpunimin ndërkufitar dhe zbatimin efektiv të ligjit.

2. Të adresohet Përqendrimi i Pronësisë së Mediave (neni 22):

Të futen dispozita specifike për monitorimin, vlerësimin dhe rregullimin e përqendrimit të pronësisë së mediave, veçanërisht në sektorin online. Këto dispozita duhet të përfshijnë zbulimin e detyrueshëm të strukturave të pronësisë, kufijtë e lidhjeve të ndërsjella të pronësisë dhe procedurat për shqyrtimin e bashkimit nga një organ i pavarur rregullator i mediave.

3. Të mbrohet të drejtat e gazetarëve dhe pavarësia redaktuese (neni 6.3):

Të parashikohet në ligj e drejta e gazetarëve për të punuar pa ndërhyrje nga pronarët e mediave apo aktorët e jashtëm. Kjo përfshin masa mbrojtëse ligjore për pavarësinë redaktuese, mekanizma për mbrojtje pushimit arbitrar nga puna dhe mbrojtje për sinjalizuesit për gazetarët që raportojnë presion të panevojshëm ose censurë.

4. Të sigurohet mbrojtje nga mbikëqyrja e paligjshme (neni 4):

Të përfshihen dispozita që ndalojnë në mënyrë eksplicite përdorimin e mjeteve digjitale të mbikëqyrjes – të tilla si softuerë për spiunim (“spyware”) – kundër gazetarëve dhe aktorëve mediatikë, me përjashtim të rrethanave të përcaktuara ngushtë me mbikëqyrje të fortë gjyqësore. Të kërkoet transparencë dhe mekanizma raportues për çdo mbikëqyrje të autorizuar.

5. Të përfshihet monitorimi i zbatimit të LELM-së:

Të krijohet një mekanizëm i pavarur monitorimi (p.sh., nëpërmjet Agjencisë për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike ose një grup pune ndërinstytucional) për të mbikëqyruar dhe raportuar mbi zbatimin e dispozitave të përafruara me LELM-në, duke siguruar përputhshmëri dhe përmirësim të vazhdueshëm.

Angazhime të paqarta për reformat e ardhshme

1. Të vendoset një afat kohor i detyrueshëm për reforma me hapa të përcaktuara:

Të transformohet Udhërrëfyesit aspirativ në një plan konkret zbatimi me hapa të qartë, afate kohore dhe institucione përgjegjëse. Çdo hap legjislativ ose politik duhet të shoqërohet nga një datë e pritshme e përfundimit dhe një rezultat i matshëm.

2. Të publikohen draftet kryesore të ligjeve dhe planet legjislative:

Të sigurohet që të gjitha propozim-ligjet që kanë të bëjnë me mediat dhe qeverisjen digjitale – duke përfshirë edhe Ligjin e ardhshëm për Shërbimet Digjitale – do të publikohen në formë drafti për konsultim publik një kohë të mjaftueshme përpara shqyrtimit në Parlament. Të përfshihen shënime shpjeguese që detajojnë se si çdo draft përputhet me direktivat e BE-së.

3. Të institucionalizohen konsultimet me shumë palë të interesuara:

Të formalizohet roli i shoqërisë civile, shoqatave të gazetarëve, sferës akademike dhe organeve të pavarura rregullatore në të gjitha fazat e procesit të reformës përmes bordeve këshilluese ose debateve publike. Komentet e tyre duhet të dokumentohen dhe të jepen përgjigje publike për to.

4. **Të krijohet një gjurmues online i reformave publike:**

Të zhvillohet një platformë online transparente, e hostuar në internet nga qeveria, që e gjurmon progresin e reformave që kanë të bëjnë me mediat, i dokumenton të gjitha konsultimet dhe ofron përditësime të rregullta mbi statusin e legjislacionit dhe planet e zbatimit.

5. **Të integrohet llogaridhënia për reformat në raportimin për anëtarësimin në BE:**

Të integrohet agjenda e reformave të mediave si një kapitull i dedikuar në procesin e raportimit të Qeverisë për integrimin në BE. Kjo do t'i mundësonte Komisionit Evropian dhe palëve të interesuara vendase të monitorojnë progresin e reformave në mënyrë më rigoroze.

Kërcënimet ndaj mediave lokale dhe atyre të specializuara

1. **Të zbatohen kritere të diferencuara për regjistrimin e mediave, në varësi të madhësisë dhe shtrirjes së tyre:**

Të zhvillohen kritere të diferencuara për përfshirjen në regjistër që i pasqyrojnë realitetet e mediave të vogla, të komunitetit, jofitimprurëse dhe në gjuhën e pakicave. Për shembull, të lejohen kombinime fleksibël të punonjësve me orar të pjesshëm, me honorar ose vullnetarë për mediat e vogla.

2. **Të sigurohen përjashtime për mediat që janë në shërbim të komuniteteve të cenushme:**

Të futen në ligj përjashtime ose dispozita të veçanta për organizatat e medias që u shërbejnë popullatave të pakicave, që jetojnë në zona të largëta ose interesave të veçanta publike, duke siguruar që pajtueshmëria rregullatore të mos përbëjë pengesë për qëndrueshmërinë e tyre.

3. **Të sigurohet mbështetje e synuar financiare dhe për zhvillim të kapaciteteve:**

Të krijohen skema grantesh, subvencione ose programe të asistencës teknike për të ndihmuar mediat lokale dhe të specializuara që të përmbushin kërkesat themelore operacionale dhe të pajtueshmërisë. Kjo mund të përfshijë mbështetje për regjistrimin ligjor, tranzicionin digjital ose zhvillimin e përmbajtjeve.

4. **Të njihen modelet jo-tradicionale dhe novatore të mediave:**

Të zgjerohet përkufizimi ligjor i subjekteve të përshtatshme mediatike për të përfshirë gazetarinë lokale, platformat e mediave qytetare dhe krijuesit e përmbajtjeve hibride, duke e njohur kontributin e tyre për pluralizmin dhe gazetarinë me interes publik.

5. **Të monitorohet ndikimi i regjistrimit në diversitetin e mediave:**

Të caktohet një rregullator i mediave ose organ i pavarur për të vlerësuar ndikimin e kritereve të regjistrimit mbi diversitetin e mediave çdo vit dhe për të rekomanduar përshtatje për të mbrojtur zërat e vegjël dhe lokalë.

Nevoja për koherencë ligjore dhe integrim

- 1. Të zhvillohet një strategji e unifikuar për mediat dhe qeverisjen digjitale:**

Të krijohet një strategji ndërsektoriale që bashkon rregullimin e mediave, shërbimet digjitale, mbrojtjen e të dhënave, sigurinë në internet dhe llogaridhënien e platformës nën një vizion të vetëm legjislativ. Kjo strategji duhet të harmonizojë parimet e LELM-së dhe LSHD-së dhe të koordinohet nga një grup pune ndërministror i nivelit të lartë.
- 2. Të harmonizohen përkufizimet dhe standardet ligjore në ligje të ndryshme:**

Të sigurohet që termat kyç (p.sh., ofruet e shërbimeve mediatike, platformë në internet, përmbajtje e dëmshme) të përcaktohen dhe përdoren në mënyrë konsekuente në Ligjin për Mediat, Ligjin për Shërbimet Digjitale dhe çdo ligj tjetër përkatës për të shmangur konfuzionin dhe konfliktin ligjor.
- 3. Të koordinohen afatet kohore të reformës dhe përfshirja e palëve të interesuara:**

Të sinkronizohen afatet kohore legjislative për Ligjin për Mediat dhe Ligjin për Shërbimet Digjitale për të mundësuar konsultime të koordinuara publike dhe koherencë të politikave. Të përfshihen dialogë të përbashkët të palëve të interesuara që trajtojnë çështje ndërsektoriale si moderimi i përmbajtjeve dhe detyrimet për transparencë.
- 4. Të kryhet një vlerësim i ndikimit në ligje të ndryshme:**

Përpara miratimit, të caktohet të bëhet një vlerësim i pavarur ligjor që hartëzon ndërveprimin e Propozim-ligjit për Mediat me kornizat e tjera ligjore përkatëse (p.sh. LSHD, GDPR, ligjet për krimin kibernetik) dhe identifikon fushat e mbivendosjes, konfliktit ose lëshimit.
- 5. Të krijohet një Forum i përhershëm për të drejtat digjitale dhe reformën e mediave:**

Të krijohet një forum ose këshill i përhershëm, i përbërë nga ekspertë të medias, profesionistë të politikave digjitale, rregullatorë dhe përfaqësues të shoqërisë civile për të këshilluar qeverinë mbi qasjet e integruara dhe për të siguruar harmonizim të vazhdueshëm me zhvillimet e BE-së.

Mbrojtje e pamjaftueshme kundër padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike (MKPSKPS)

- 1. Të prezantohet një kornizë legjislative kundër MKPSKPS-së:**

Të miratohen dispozita specifike ligjore të modeluara sipas Direktivës së BE-së për MKPSKPS për t'u mundësuar gjykatave të njohin dhe të hedhin poshtë paditë e pabaza që synojnë të heshtin raportimin që është në interes publik. Kjo kornizë duhet të përfshijë një përkufizim të qartë të MKPSKPS-ës dhe kriteret për hedhjen poshtë të hershme të padive.

2. Të vendosen procedura për hedhjen poshtë të hershme të padive:

T'u mundësohet gjykatave të bëjnë një vlerësim paraprak (*prima facie*) të rasteve të MKPSKPS-së në një fazë të hershme. Nëse pretendimi është i mangët dhe synon dukshëm frikësimin ose ndëshkimin e të akuzuarit për pjesëmarrjen e tij në debat publik, duhet të hidhet poshtë përfundimisht.

3. Të bëhet e detyrueshme që barra e provës të bie mbi paditësit në rastet e qarta të MKPSKPS-së

Të kërkohet nga paditësit të dëshmojnë legjitimitetin e rastit së tyre kur dyshohet se bëhet fjalë për MKPSKPS. Kjo i dekurajon proceset gjyqësore joserioze dhe e largon përgjegjësinë për të justifikuar veprimet ligjore nga gazetarët.

4. Të zbatohen sanksione për paditësit abuzivë:

Gjykatat duhet të autorizohen për të vendosur gjoha financiare ose procedurale ndaj paditësve që rezultojnë se po abuzojnë me procesin ligjor nëpërmjet MKPSKPS-ve, duke përfshirë mbulimin e kostove ligjore të të akuzuarit dhe dëmshpërblim për trajtimin ngacmues.

5. Të krijohen mekanizma të ndihmës juridike dhe të mbështetjes për gazetarët:

Të krijohet një fond i dedikuar për ndihmë juridike ose sistemi mbështetës – mundësisht përmes Avokatit të shtetit ose në bashkëpunim me shoqërinë civile – për të ndihmuar gazetarët dhe mediat që përballen me MKPSKPS, duke siguruar qasje në mbrojtje ligjore kompetente, pavarësisht nga mjetet financiare.

Mungesa e transparencës mbi pronësinë e mediave

1. Të krijohet një regjistër i centralizuar, i qasshëm nga publiku, i pronësisë së mediave:

Të kërkohet nga të gjitha subjektet mediatike – transmetuese, të shtypura dhe në internet – të zbulojnë informacione gjithëpërfshirëse të pronësisë, duke përfshirë pronarët përfitues, burimet e financimit dhe lidhjet e ndërsjella të pronësisë. Regjistri duhet të përditësohet rregullisht dhe të jetë i kërkueshëm lehtësisht nga publiku.

2. Të bëhet i detyrueshëm zbulimi i pronarëve përfitues

Të ndryshohet ligji për të përfshirë një detyrim ligjor për kompanitë mediatike për të deklaruar jo vetëm pronësinë e drejtpërdrejtë, por edhe pronarët përfitues përfundimtarë, sipas standardeve të BE-së kundër pastrimit të parave.

3. Të sigurohet mbikëqyrje dhe verifikim i pavarur rregullator:

Të caktohet një organ i pavarur rregullator mediatik me kompetenca hetimore për të bërë mbikëqyrje të transparencës. Rregullatori duhet të ngarkohet me detyrën e verifikimit të informacionit të deklaruar dhe të marrë masa ndëshkuese në rast mospërputhjeje apo keqinterpretimi.

4. Të zgjerohen kërkesat për transparencë për të përfshirë mediat online dhe ato digjitale:

Të zbatohen të njëjtat kërkesa për zbulimin e pronësisë për platformat e mediave online, duke përfshirë bloget dhe portalet që angazhohen në aktivitete gazetareske ose tërheqin audiencë të konsiderueshme.

5. **Të shpalosen lidhjet politike dhe financiare:**

Mediave duhet gjithashtu t'u kërkohej të shpalosin çdo mbështetje të drejtpërdrejtë financiare, hua ose kontrata reklamimi të marra nga subjektet politike, institucionet shtetërore ose bizneset e lidhura me to.

Ndikimi i vazhdueshëm politik dhe censura e butë

1. **Të rregullohet reklamimi shtetëror përmes kritereve transparente dhe jodiskriminuese:**

Të futet një kornizë ligjore që e rregullon shpërndarjen e fondeve publike dhe reklamave shtetërore nëpër media. Kriteret e shpërndarjes duhet të bazohen në masa objektive si arritja e audiencës, cilësia redaktuese dhe përmbajtja me interes publik - e jo në rreshtimin politik.

2. **Publikimi i raporteve të detajuara mbi marrëdhëniet financiare midis shtetit dhe mediave:**

Të kërkohej nga të gjitha organet qeveritare dhe ndërmarrjet shtetërore që të zbulojnë kontratat e reklamave dhe shpenzimet e lidhura me mediat në kohë reale ose në baza tremujore. Këto raporte duhet të përfshijnë mediat pranuese, vlerën e kontratës, qëllimin, dhe procesin e përzgjedhjes.

3. **Të forcohet pavarësia e organeve rregullatore:**

Të reformohen proceset e emërimit dhe mbikëqyrjes për organet rregullatore të mediave për të siguruar pavarësinë e tyre nga aktorët politikë. Të vendosen standarde të performancës dhe mekanizma të llogaridhënies parlamentare.

4. **Të ndalohet ndërhyrja joformale politike:**

Të përfshihen dispozita specifike në Ligjin për Mediat që i kriminalizojnë ose i sanksionojnë ndërhyrjet politike joformale në vendimet redaktuese, duke përfshirë kërcënimet verbale, presionin nga funksionarët qeveritarë dhe keqpërdorimin e detyrës zyrtare për të ndikuar në media.

5. **Të mbështetet gazetaria e pavarur përmes financimit konkurrues publik:**

Të zhvillohen skema të financimit publik (p.sh. grante për gazetari hulumtuese, inovacion në media dhe përmbajtje të larmishme) që administrohen përmes komisioneve të pavarura, të udhëhequra nga ekspertë. Këto skema duhet të inkurajojnë pavarësinë redaktuese dhe të sigurojnë pluralizëm pa favorizime.

Megjithëse përpjekjet për reformimin e legjislacionit për mediat në Maqedoninë e Veriut janë për t'u lavdëruar, propozimet aktuale janë të pamjaftueshme për të garantuar lirinë e

mediave dhe t'u harmonizuar plotësisht me standardet e BE-së. Reformat gjithëpërfshirëse që i adresojnë shqetësimet e përshkruara janë thelbësore për të nxitur një mjedis mediatik të lirë, të pavarur dhe pluralist, i cili është një gur themel i shoqërisë demokratike dhe një parakusht për integrimin në BE.

Fondacioni Metamorfozis